



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 4.1 dhe 40.2 shkronjën i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 2 pika 11 Statutit të Komunës, Nenin 52 dhe 53 të Ligjit nr.05-L-031 për procedurën e përgjithshme administrative. Nenit 15 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL- për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, me kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi 01nr.112-9134/23 të datës:17.03.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të, të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më datën 31.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Zëvendësimi behët:
- 1.1. Ish përfaqësuesi i Famullisë Katolike **Don Agim Qerkini**, zëvendësohet me përfaqësuesin e Famullisë Katolike në Klinë **Don Jeton Thaqi**.
2. Zëvendësimi behet pas kërkesës së parashtruar, me rastin e ndërrimit të përfaqësuesit të Famullisë Katolike Zoja e Këshillit të mirë në Klinë.
3. Ky vendim është pjesë e vendimit 01nr.06-10158/2022 i datës 25.03.2022 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
4. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarit i ri i KKS-së, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-10158 /2023
Klinë, më 04.04 /2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi